



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Komuna e Gjakovës

Dt.06.09.2024

Nr.01/2024

PROCESVERBALI

Nga Dëgjimet Buxhetor të organizuara nga Kuvendi i Komunës me Përfaqësuesit e OJQ-ve të Mbështetur nga OSBE-ja, të mbajtur me dt.06.09.2024 në fillim në ora 09:30 në Hotel “Çarshia e Jupave” Gjakovë .

Të Pranishëm: Kryesuesja e Kuvendit të Komunës znj. Arbëneshja Kuqi, Drejtorët: z. Durim Halilaj, 5 anëtar të Kuvendit dhe të KPF-së, znj. Natalja Rusu përfaqësuese e OSBES-së përfaqësues të Zyrës për Informim të OSBE-së , të mediave dhe gjithsejti 22 qytetar.

znj. Arbëneshja Kuqi: Të nderuar anëtar të Komiteti për Politik dhe Financa të Kuvendit të Komunës i nderuar z. Durim Halilaj Drejtor i drejtorisë për Buxhet dhe Financa e nderuara znj. Natalja Rusu përfaqësuese e OSBES-së faleminderit që je sot këtu prezent me ne, në këtë dëgjim buxhetor të Kuvendi i Komunës për Buxhetin e Komunës së Gjakovës për vitin 2025, për çka e falënderojmë edhe OSB-në për përkrahjen, deri tani janë mbajtur 9 dëgjime Buxhetore të organizuara nga ekzekutivi i Komunës së Gjakovës konkretisht nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, sipas afateve ligjore para datës 1 Shtator më është dorëzuar Draft Buxheti sipas legjislacionit në fuqi dhe ju kemi shpërndarë anëtarëve të Kuvendit, ne si Kuvend i kemi organizuar dy dëgjime Buxhetore njëra njëri është ky që jemi tani që është organizuar me përkrahjen e OSBE-së me Organizatat joqeveritare, dhe tjetri është i thirrur sot prej orës 13:30 që është organizuar për Qytetarët e Komunës së Gjakovës, unë nuk do të zgjatem më shumë dhe meqenëse e kemi përfaqësuesen e OSBE-së znj. Natalja Rusu të cilën e ftoj që ta merr fjalën .

znj. Natalia Rusu: Faleminderit që na u bashkuat në këtë ngjarje të rëndësishme, si pjesë e përpjekjeve komunale në përgatitjen e dokumentit buxhetor, të mbështetur nga Misioni i OSBE-së në Kosovë. Është kënaqësi të qëndroj përkrah Kryesuesit të nderuar të Kuvendit Komunal dhe të përgëzoj për përkushtimin tuaj për zbatimin e kërkesave të akteve nënligjore që kanë të bëjnë me procesin buxhetor, të organizuar nga pushteti ekzekutiv, dhe tani nga legjislativi dhe përfshirja e të gjitha grupeve të shoqërisë civile. Kjo qasje siguron që zërat e të gjithë banorëve të dëgjohen dhe të përfshihen në draft përmes procesit të vendimmarrjes.

Ne përgëzojmë arritjet tuaja të jashtëzakonshme në rritjen e konsiderueshme të buxhetit të përgjithshëm, duke përfshirë mbledhjen e të hyrave vetanake dhe planet për t'u kthyer në komunitet përmes investimeve kapitale. Kjo shpreh qartë menaxhimin efikas financiar, përgjegjësinë fiskale dhe transparencën.

Një shembull i mirë në këtë komunë është edhe përfshirja e kërkesave të banorëve nga viti i kaluar në dokumentin buxhetor dhe zbatimi i projekteve të dala nga seancat buxhetore.

Jemi të vetëdijshëm se komuna u shtri në zonat rurale dhe inkurajoi pjesëmarrjen e grupeve të ndryshme në këto ngjarje. Ne ju përgëzojmë për përfshirjen e madhe të këshillave vendore. Megjithatë, kemi vërejtur pjesëmarrje të ulët të grave, të rinjve dhe personave me aftësi të kufizuara në të gjitha dëgjetimet buxhetore të organizuara në vitin 2024. Përveç kësaj, ju duhet të përpiqeni për një pjesëmarrje më gjithëpërfshirëse duke iu drejtuar komuniteteve joshumicë dhe komunitetit të biznesit. Angazhimi i një game të larmishme zërash siguron që buxheti komunal të reflektojë me të vërtetë nevojat e të gjithë banorëve. Ju inkurajojmë që të vazhdoni me masa dhe konsiderata të tilla pozitive për të përfshirë kontributin e banorëve në dokumentin përfundimtar të buxhetit. Është e domosdoshme zhvillimi i dialogut me banorët për politikën dhe shpërndarjen e burimeve të nevojshme për komunitetin tuaj. Si përfundim, këto seanca dëgjimore për buxhetin nuk janë thjesht një formalitet; ato janë një dëshmi e misionit dhe përkushtimit të komunës për qeverisje të përgjegjshme dhe pjesëmarrjen e qytetarëve. Faleminderit për vëmendjen dhe ju uroj punë progresive.

z. Durim Halilaj: Bazuar në tabelat e buxhetit komunal nga vitet e kaluara dhe me qëllim të vazhdimin të reformave të procesit buxhetor, buxheti komunal për vitin 2025 është planifikuar dhe pasqyrohet sipas strukturës bazë të programeve dhe nën-programeve buxhetore. Për të përmirësuar gjithë-përfshirjen, transparencën dhe kredibilitetin e formulimit të buxhetit komunal, synohet që hartimi i buxhetit të ndërtohet në përputhje me dispozitat e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal dhe Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

Prioritet për financim kanë projektet që janë të vazhdueshme që kanë filluar në vitet e mëparshme dhe atyre që janë në harmoni me prioritetet e Komunës.

Financimi komunal përfshinë: grantet specifike operative për arsim para universitar dhe shëndetësi primare, grantet për kompetencat e shtuara, të hyrat vetanake të komunave, transferet për kompetencat e deleguara, grantet e jashtëzakonshme, ndihma financiare nga jashtë. Ndërsa, aspekti i huamarrjes së komunave do të jetë si opsion i mundshëm i financimit që është paraparë në ligjin përkatës dhe në kuadër të rregullës fiskale të përcaktuar në LMFPP të dakorduar me Misionin e FMN-së. Të gjitha të hyrat nga burimet në vijim janë të hyra vetanake të komunës: tatimi në pronë, taksat komunale, gjobat, tarifatat dhe pagesat në pajtim me autoritetin që u është dhënë komunave me LFPL. Parashikimi i të hyrave vetanake komunale 2025-2027

Përveç Granteve të marra nga niveli qendror, për qëllimet e mbulimit të shpenzimeve të përgjithshme, Komuna mbledh edhe të hyra vetanake. Të hyrat vetanake në Komunën e Gjakovës realizohen në bazë të Rregullores mbi Tarifatat dhe Ngarkesat Komunale, të Rregullores mbi Tatimin në Pronë si dhe dispozitave tjera ligjore të cilat përcaktojnë llojet e ndryshme të hyrave komunale me të cilat komuna ka të drejtë të caktoj dhe inkasoj siç janë licencat e bizneseve dhe të hyrat tjera vetanake komunale.

Bazën e të hyrave komunale e përbëjnë Tatimi në pronë të cilat të hyra duhet shpenzuar ekskluzivisht në sferën e projekteve për investime kapitale në infrastrukturën rrugore, ujësjellës, kanalizim etj.

Me Qarkoren buxhetore nr. 2025/01, për komunën e Gjakovës, për vitet: 2025 – 2027 është përcaktuar Planin i të hyrave vetanake si vijon: Viti 2025 është 5,934,237.00 €, Viti është 2026.. 6,406,561.00 €, Viti 2027 është 6,887,230.00 €.

Kryesuesja: E hapim debatin për ju të pranishëm për të gjithë kërkesat vërejtjet dhe sugjerimet e juaja.

z. Ideal Zhveli: Fillimisht ju përgëzoj për organizimin e dëgjimeve buxhetore, ne i kemi prezantuar edhe në dëgjetimin buxhetor që është bërë disa ditë më herët por dua ti prezantoj edhe një herë sot këtu sepse për disa nga kërkesat nuk kemi marrë përgjigjeje ende, fillimisht për Qendrën Rinore e kemi cekur disa herë dhe po kërkojmë që të rritet Buxheti për Qendrën Rinore si dhe për subvencione kërkojmë që të planifikohet rritja e Subvencioneve për vitin

2025 për rini, në këtë vite janë financuar 10 organizata dhe buxheti ka qenë 10.000€ andaj kërkojmë që të rritet buxheti për rini dhe për start-up të ketë një thirrje të veçantë për rini si dhe kërkojmë që të rregullohen Zebrat dhe Ndriçimi në Komunën e Gjakovës, kërkojmë që të rregullohet Sahat Kulla, Kërkojmë një përgjigjeje se a do të zgjerohet rrjeti i ngrohtores si dhe për trotuare sidomos për personat me aftësi të kufizuara edhe në Qendër nuk janë bërë ashtu siç duhet sidomos për personat e verbër, shumica e trotuareve në Komunën e Gjakovës nuk i plotësojnë kushtet as minimale për personat me aftësi të kufizuara, si dhe vendosja e kamerave në një vend ku përdorimi i drogës po ndodhë është ish pazari andaj kërkojmë që të vendosen kamerat në këtë hapësirë .

z. Berat Thaqi: Cilat janë projektet konkrete të komunës për vitin 2025 dhe pastaj mundemi me diskutua për ato projekte konkrete.

znj. Dorina Lluka-Dejvis: Unë jam e interesuar dhe kërkoji që të rriten subvencionet sidomos për organizatat rinore sepse edhe Ministria e Rinisë i ka ndalur subvencionet për organizatat rinore, A kanë mundësi që të subvencionohen edhe organizatat që merren me Pensionistët sepse ka shumë nevojë që të kemi organizata që merren më shumë me pensionistë.

z. Blendi Haxhikadrija: Rritja e subvencioneve është jetike për rinin tonë sepse aktivitetet rinore dhe sportive e mbajnë rinin këtu, andaj kërkojmë që të rriten subvencionet në klubet e sporeve. Është esenciale përkrahja e femrave në Sporte, Klubi i volejbollit Vllazënim i ka 250 femra anëtare dhe kjo është diçka madhështore, zhvillimi i dukurive të këqija është shumë i madhe dhe rinis tonë po i shkakton dëme të mëdha andaj mundësia e vetme është që të investojmë në sektorin e rinis dhe të Sportit, për mua është absurde që Komuna e Rahovecit ti ketë deri 300,000€ buxhet për rini dhe komuna e Gjakovës i ka 120,000€ kjo është apsurde, mos investimi në infrastrukturë, ne së bashku me disa organizata kemi filluar një iniciativë për rregullimin e terenit të sportit tek Shkolla teknike dhe e kemi rregulluar ndriçimin e kemi bërë nivelizimin e terenit dhe është shumë e nevojshme investimi në sporte. Subvencioni në komunën e Suharekës është mbi 100% më shumë se në Komunën e Gjakovës për ekipin e Volejbollit ku ekipi i Gjakovës është në Vendin e parë andaj kërkoj që të rriten subvencionet në këtë sektor sepse jemi lodhur shumë dhe është e pa mundur të vazhdohet kështu. Tereni i Sportit që ka qenë prapa Hallës së Sportit është dhënë për teren të futbollit dhe janë bllokuar të gjitha sportet tjera, gjithashtu e keni ndërtuar terrenin e futbollit në Shkukëz, tani është duke punuar në Stadionin e Qytetit e çka është bërë për Sportet me Dorë, pra nuk është bërë asgjë.

z. Durim Halilaj: Unë e potencova edhe më herët se ka rritje Buxhetore për Subvenconet në Buxhetin e vitit 2025, Në qarkoren e dytë buxhetore cekohen saktë tavanin i kategorive të ndryshme Buxhetore për shkak se kur të bëhet Buxheti i Shteti të jenë të përcaktuar a saktë kategoritë ekonomike pra nuk i kemi duart e lira komunat me vendos për tavanin e kategorive ekonomike.

z. Art Kupa: Zgjidhja për këtë problem nuk mundet me ardhë nga Drejtori por duheni të drejtoheni dhe të ndikoni tek politikat sektoriale konkretisht tek DKRS-ja dhe ti paraqitni propozimet dhe kërkesat e juaja.

znj. Dorina Lluka-Dejvis: Të gjithë ne duhet të angazhohemi që të kontribuojmë për zhvillimin e Sportit sepse ne i kemi vizituar edhe vendet e ndryshme të perëndimit dhe i kemi bërë krahasimin e rinis apo të fëmijëve tanë me fëmijët e tyre që fëmijët tanë edhe fizikisht janë më pak të zhvilluar e këtu kanë ndikuar shumë faktor sidomos të ushqyerit jo të mirë dhe jo të shëndetshme, që unë mendoj se është shqetësuese .

Përfaqësuesi i YAMCA: A ka komuna ndonjë plan që të investoj në terrene Sportive në përjashtim të Stadionit dhe terreneve të Futbollit, sepse e kemi parë se plot fëmijë lozin në rrugë që nuk kanë ku të zhvillojnë aktivitetet sportive .

z. Durim Halilaj: Komuna e Gjakovës ka investuar në terrene Sportive në disa Bashkësi Lokale dhe jemi në përfundim të terreneve të Tenisit dhe në bashkëpunim me drejtorin e Kulturës jemi duke planifikuar edhe investime tjera në terrenet sportive, këtu jemi që të kemi kërkesë konkret e jo të përgjithshme por të kemi kërkesë për realizimin e projekteve konkrete. Në këtë vit kemi filluar edhe me buxhetimin me pjesëmarrje ku qytetarët me vota e kanë caktuar se cili projekt do të realizohet në lokalitetin e tyre. Në vitet e ardhshme edhe shuma e subvencioneve të ndara për dy ndërmarrjet publike mundet me u shpërnda në këto kategori edhe në vitin e kaluar me tejkalim i kemi shpërndarë dhe kemi përkrahur sektorin e rinis me subvencione .

z. Ali Tafarshiku: Fillimisht një kritik që nuk është sjellë këtu as një material për këtë buxhet por po diktojmë pa ndonjë dokument, Për sa i përket ndërtimit të terreneve të sportit për vitin 2025 këtu në këtë buxhet nuk është i paplanifikuar asnjë teren sportiv, tek Subvencionet për Sport është shuma e vërtet se edhe ne si opozitë jemi gjet para një aktit të kryer kur kanë ardhur kërkesat për miratim të subvencioneve për KF Vllazimi , ne kemi pasur kërkesë edhe për klubet tjera, Unë e kamë shprehur papajtueshmërinë time të plotë për ndarjen e subvencioneve në zyrën e Kryetarit për subvencionimin e ngrohtores pse me e mbulua dështimin e dikujt tjetër me subvencione, kërkojmë që ta rishikoni këtë pozicion dhe ta shpërndani këtë shumë në subvencione për Sport dhe Rini sepse kjo ndërmarrje merr subvencione edhe nga Ministria.

z. Durim Halilaj: Interesi i Komunës është me e hartua një Buxhet transparent, ato subvencione që po thuhet këtu te kryetari ato mjete kanë me ardhë prapë në Kuvend, dhe ato mjete janë planifikuar që Ngrohtorja e Qytetit që do të jetë profitabile, ka pasur shumë vështirësi me blerjen e biomasës për shkak të rritjes së çmimit nga 70 € në 240 € dhe ne kemi marrëveshje me Ministrinë që edhe ne ta përkrahim ndërmarrjen tonë publike gjithashtu situata njëjtë është edhe në stacionin e Autobusëve, dhe sa i përket mjeteve që janë ndarë për Buxhetin për subvencione asnjëherë nuk janë prek mjetet e ndara për klubet sportive, për zgjerimin e ngrohtores që nga viti 2015 e kemi pasur marrëveshjen për bashkëfinancim por që dy vite Kosova është në Sanksione. Për ndërtimin e Transittit aty janë mbi 2.5 milion euro investim në instalimet nëntokësore që janë të ngrohtores të Ujësjiellit të rrymës, kanalizime etj.

z. Sylejman Morava: Unë mendoj se ndarja e subvencioneve në mënyrë të barabartë për të gjitha OJQ-të nuk është në rregull sepse ka OJQ që brenda vitit e ka vetëm një aktivitet ndërsa ka të tjera që kanë aktivitete të përditshme andaj nuk është e drejtë me ju nda subvencione në mënyrë të barabartë të gjithave, kështu që propozoj që të keni parasysh këtë në të ardhmen .

znj. Shqipe Bejtullahu: Disa OJQ kanë fonde dhe mendoj se duhet me u bë solidar me organizatat tjera që nuk kanë fonde ky është propozimi im .

znj. Dorina Lluka Dejvis: Ne si organizata të shoqërisë civile jemi të prekur edhe nga sanksionet që janë aplikuar ndaj Kosovës nga BE-ja përfshirë këtu që edhe niveli qendror i ka ndal fondet për organizatat rinore ku në këtë vit asnjë thirrje nuk është hapur për rini .

z. Ali Tafarshiku: Masat janë me kohë të caktuar, ne jemi interesuar edhe në vitin e kaluar por në momentin që ata po të qesin faktet se nuk janë plotësuar kriteret e kërkuara .

z. Durim Halilaj: Ne për vitin e ardhëshëm do të ndajmë një fond të caktuar për grandet e biznesit për të rinjtë por fillimisht do të shohim bazën ligjore nëse është e lejueshme dhe do të jetë një thirrje për aplikim vetëm për të rinjtë .

znj. Fllaza Lama: Për kërkesën lidhur me rritjen e subvencioneve për rini unë mendoj se është kërkesë e arsyeshme dhe duhet të rriten subvencionet për rini. Kërkoj që të subvencionohet edhe organizata Kryqi i Kuqë, ne nuk kemi asnjë përkrahje nga Komuna e Gjakovës në përjashtim të përkrahjes nga Drejtoria e Shëndetësisë një herë një vit me një shumë të caktuar, ne të hyrat i kemi shumë të vogla ku realizohen vetëm nga kandidatet për certifikatën e ndihmës së parë që janë 15€ dhe nga kjo shumë ne vetëm 30% i marrim ndërsa pjesa tjetër shkon në nivelin qendror, dhe ne nuk po mundemi me funksionu pa pasur përkrahje sepse edhe ne po i kemi shpenzimet e domosdoshme, degët tjera të Kryqit të Kuq në Kosovë përkrahen nga komunat në vazhdimësi.

z. Durim Halilaj: Edhe Drejtoria e Shëndetësisë është e komunës ne i kemi përkrahur në të kaluarën disa nga organizatat por Zyra Kombëtare e Auditorit na ka dhënë vërejtje lidhur me këto përkrahje dhe kanë kërkuar që të gjejmë mënyra për me i subvencionuar këto organizata sepse nuk janë pjesë e Institucionit të Komunës dhe duhet të zbatohet rregulloja për subvencionimin e OJQ-ve .

z. Berat Thaqi: Unë kamë bërë pyetje por përgjigjeje nuk kamë marrë nëse në sektorin e Sporti janë ndarë një shumë e mjeteve me çfarë baze janë ndarë ato mjete çka është marrë për bazë gjatë planifikimit, a ka ndonjë planifikim apo strategji .

z. Durim Halilaj: Të gjitha drejtoritë i kanë planifikimet dhe i kanë kërkesat dhe prioritetet të cilat i planifikon në buxhet për vitin fiskal, pra merren kërkesat e qytetarëve dhe të organizatave e pastaj shikohen rëndësia dhe prioriteti i tyre dhe hyjnë në draft buxhetin sikur që janë tani .

z. Blendi Haxhikadija: Ne e kemi bërë një kërkesë të gjitha OJQ-të dhe Klubet Shpotive lidhur me lejimin e pagesës së mjeteve në fillim.

z. Durim Halilaj: Dy hapa teknik i keni bërë të gabueshëm duhet të bëhet kërkesa për avancë e pastaj lëshohen mjetet sepse janë procedura që i përcakton ligji .

z. Çlirim Shabani: Unë dua ti ngris disa çështje në emër të organizatës së të verbërve ku ka mungesa të vijave orientuese në trotuaret e rrugëve edhe në trotuarin në Qendër shiritat orientuese janë jo mirë të vendosura gjithashtu pjerrinat nuk janë të vendosura mirë dhe në shumicën e trotuareve në Komunën e Gjakovës nuk ka pjerrina .

Kryesuesja znj. Arbënesha Kuqi: Meqenëse se nuk ka diskutues të tjerë ju falënderojmë të gjithave për pjesëmarrje dhe OSBE-në për mbështetje dhe mirë u takofshim në takimet tjera.

Project: Promoting quality in public processes III
Activity 2.7. Advancing municipal financial management, auditing and accountability
06 September 2024, Hotel "Carshija e Jupa ve" Gjakovë/Dakovica

List of participants

	Name and Surname Emri dhe Mbiemri Imei prezime	Contact Kontakti Kontakt	Signature Nënshkrimi Potpis
1.	Albin Mehmeti	K. K. - Gjakovë	
2.	Ali Idrizi	U. V. - Gjakovë	
3.	Enver Hoxha	K. Gjakovë	
4.	Himza Basha	Z. Z. Gjakovë	
5.	Krenar Bushi	K. K. - Gjakovë	
6.	Shkëlqim Zekaj	044 385593	
7.	Arben Xhaxhi	044 407513	
8.	Muhar Rexhepi	045-933-058	
9.	Enver Shabani	044-659-641	
10.	Arben Hoxha	045-837 41168	
11.	Shkëlqim Hoxha	044-235-856	
12.	Arben Rexhepi	044-425-222	



OSCE Mission in Kosovo

+383 (0)49-957-362

art.kupa@osce.org

osce.org/kosovo @oscekosovo

	Name and Surname Emri dhe Mbiemri Ime i prezime	Contact Kontakti Kontakt	Signature Nënshkrimi Potpis
13.	DORINA LUKA NANGS	045 643 823	
14.	Edona Sadriu	049 188 540	
15.	SHQIRJE BEJTOZARI	044 - 188 - 336	
16.	BEUNA HAXHIMKADIRJA	049 444 381	
17.	MDHIL ZHANGELI	045 483 003	
18.	Shlendera Jomura	044-458-612	
19.	Art Lema	049 957 362	
20.	ADRIAN VASODERIN	049 501 888	
21.	DURIM HALICAJ	044 334 - 695	
22.			
23.			
24.			
25.			
26.			
27.			



OSCE Mission in Kosovo

+383 (0)49-957-362

art.kupa@osce.org

osce.org/kosovo

@oscekosovo